UDHËZIM
Nr.2, datë 18.3.2005

PËR RREGULLAT QË DUHEN RESPEKTUAR PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NË FUSHATË ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 18.3.2005, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Dëshira Subashi	Anëtar
Dodë Prenga	Anëtar

Në mbështetje të nenit 3, nenit 5, nenit 29, pika 1, dhe nenit 135 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë," i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Parime të përgjithshme

Neni 1

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat që duhen zbatuar për afishimin e materialeve propagandistike gjatë periudhës zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2005.

Neni 2

1. Organet e qeverisjes vendore janë të detyruara të caktojnë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme vendet publike për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore.
2. Caktimi i vendeve për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore bëhet jo më vonë se 10 ditë nga dita e daljes së Dekretit të Presidentit, për caktimin e datës së zgjedhjeve, bëhet publik dhe u njoftohet partive politike.

Neni 3

Për qëllim të këtij udhëzimi partitë pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin 2005 ndahen në parti parlamentare dhe parti joparlamentare.

Neni 4
Caktimi i vendeve të afishimit

1. Caktimi i vendeve publike për afishim realizohet duke përcaktuar vende, sipërfaqe dhe kohë afishimi të barabarta për secilën parti, brenda grupit ku bën pjesë.
2. Për partitë parlamentare, vendi dhe sipërfaqja, për afishimin e materialeve propagandistike, është sa dyfishi i vendit dhe sipërfaqes që u caktohet partive joparlamentare.
3. Organet e qeverisjes vendore, në njësitë administrative të të cilave ka dy ose më shumë zona zgjedhore duhet të bëjnë caktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike të subjekteve zgjedhore, në përputhje me hartën zgjedhore, për secilën prej zonave zgjedhore.

4. Në caktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike organet e qeverisjes vendore duhet të mbajnë parasysh:
- Sheshet publike dhe afërsinë e tyre me qendrën e njësisë administrative përkatëse;
- Rrugët kryesore;
- Vendet e veçanta të caktuara për afishim;

- Mundësinë e ndriçimit.

5. Ndalohet vendosja dhe afishimi i materialeve propagandistike zgjedhore në ndërtesat e institucioneve publike.

Neni 5
Respektimi i barazisë

1. Vënia në dispozicion e sipërfaqeve për afishimin e materialeve propagandistike, bëhet me të njëjtin çmim për sipërfaqe dhe kohë afishimi të barabartë.

Neni 6
Personat juridikë dhe fizikë

Personat juridikë apo fizikë, që ushtrojnë aktivitet në fushën e reklamave në territorin e njësisë vendore përkatëse, janë të detyruar që të respektojnë parimet e barazisë ndërmjet subjekteve zgjedhore, në rastin kur afishojnë materiale propogandistike zgjedhore.

Neni 7
Kompensimi

1. Në rastet kur KZZ konstaton shkelje të dispozitave të këtij udhëzimi, me vendim urdhëron kompensimet përkatëse të cilat realizohen menjëherë.

2. Vendimi i KZZ-së i dërgohet menjëherë Organit të Qeversisjes Vendore përkatëse.

Neni 8
Sanksionet

Në rastet kur KQZ konstaton kundërvajtje administrative, si dhe pasi ka marrë mendimin e KZZ-së përkatëse, vendos sanksione në përputhje me ligjin nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 9

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.